

Prishtinë: 06/09/2006
ERO/CPD_D_07_09_06

Nga: Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve (DMK) i Zyres së Rregullatorit për Energji

Për: Divizionin e Furnizimit në KEK (Departamenti për kujdes ndaj konsumatorëve)
Konsumatorin: Z. Idriz Gerguri, adresa: Albanë e Vogël F. Kosovë

Cc: Zyra për çështje Rregulative në KEK

Lënda: Miratim i Marrëveshjes Nr. 1081 të datës 01.09.2006 të arritur ne mes të Dep. për kujdes ndaj konsumatorëve (Div. Furnizimit KEK) dhe konsumatorit Idriz Gerguri

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorit e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Përgjigjen e KEK-ut, Nr DPR – C01-, me datë 12.06.2006;
4. Ankesën e bërë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) të Zyrës së Rregullatorit për Energji sipas nenit 14.1 të Rregullit mbi Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të regjistruar me 13.07.2006; me numer regjistrimi 9/7 2006;
5. Inicimit të procesit të Zgjidhjes Alternative të Kontesteve (ZAK-Negocim) në mes të KEK-ut dhe konsumatorit nga ana e DMK të ZRRE-së me datë 14.07.2006;
6. Pajtueshmërinë e palëve për të negocuar nga data 14.07.2006;
7. Ofertën e KEK-ut ofruar konsumatorit me datë 14.08.2006 Nr. DPR – CO1 – 10;
8. Marrëveshjen e arritur në mes të Div. Të Furnizimit (Dep. Kujdes ndaj konsumatorëve KEK) dhe konsumatorit të datës 01.09.2006 nr 1081;
9. Nenin 21.4 dhe 21.7 të Rregullit mbi Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
10. Në përputhshmëri me Nenin 14.3 të Rregullës mbi procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve me datë 06.09.2006 ka shqyrtuar marrëveshjen e paraqitur nga Divizioni i Furnizimit të KEK-ut (Departamenti për kujdes ndaj konsumatorëve) dhe bazuar në faktet e paraqitura dhe në bazë të kompetencave të dhëna sipas Nenit 14.3 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve; Kryesuesi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve merr këtë:

VENDIM

Aprovon marrëveshjen Nr. 1081 të datës 01.09.2006 e arritur në mes të Divizionit të Furnizimit në KEK (Dep. për Kujdes ndaj konsumatorëve) dhe konsumatorit Idriz Gerguri nga Albana e Vogël F. Kosovë.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tijë të drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve të ZRRE-së të datës 13.07.2006 nr.9/7 2006, ka apeluar përgjigjen e KEK-ut Nr DPR – C01- të datës 12.06.2006, e cila përgjigje i është dhënë në lidhje me kërkesën e konsumatorit për përmirësimin e ngarkesës për energjinë e konsumuar mbi 800 kWh (mbilimit).

KEK-u në përgjigjen e dhënë konsumatorit ka theksuar përmirësimet që ka bërë në faturat e konsumatorit deri me datën 12.06.2006.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve duke vlerësuar ankesën e konsumatorit drejtuar ZRRE-së, përgjigjen e KEK-u dhënë konsumatorit dhe duke u bazuar në Rregullin mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë (Kapitulli IV, Neni 21.4), u ka propozuar palëve procesin e negociimit si mjet për zgjidhjen e këtij kontesti. Palët janë pajtuar që të hyjnë në proces të negociimit i cili ka rezultuar me marrëveshjen e arritur në mes të palëve.

Divizioni i Furnizimit në KEK (Dep. për kujdes ndaj konsumatorëve) duke respektuar Nenin 21.7 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, e ka dërguar për aprovim në DMK të ZRRE-së marrëveshjen e arritur me konsumatorin.

Kryesuesi i DMK të ZRRE-së me datë 06.09.2006 ka analizuar marrëveshjen e arritur dhe ka vendosur që e njëjta të miratohet pasi që:

1. Marrëveshja nuk cenon interesat e palëve të treta;
2. Marrëveshja nuk është diskriminuese ndaj konsumatorëve tjerë;
3. Është rezultat i negociimit direkt në mes të palëve
4. Eshtë nënshkruar nga të dyja palët.
5. Nuk është në kundërshtim me ligjet e aplikueshme, rregullat e lëshuara nga ZRRE dhe sistemin tarifor të aplikueshëm.

DEPARTAMENTI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE
ERO/CPD_D_06_09_06, dt 06.09.2006

Kryesuesi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve
Azem Kastrati



KËSHILLË JURIDIKE: Kunder këtij vendimi palët mund të ankohet në Bordin e ZRRE-së në afat prej katërmëdhjetë (14) ditëve kalendarikë nga dita e marrjes së të njëjtit nga palët, apo nga dita e shpalljes në faqen elektronike të ZRRE-së, cila do që ndodhë më parë.